

Edmond SHEHI

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

ÇËSHTJA SHQIPTARE NË ARKIVAT BRITANIKE (1919-1923)

Përmbledhje: Punimi “Çështja shqiptare në arkivat britanike në vitet 1919-1923”, së pari, ka për qëllim të hedhë dritë mbi dokumentet zyrtare të çështjes shqiptare gjatë kohës kur u mbajt Konferenca e Paqes në Paris dhe, pas saj; së dyti, qëndrimin zyrtar dhe jozyrtar të Zyrës së Jashtme Britanike (Foreign Office) mbi çështjen shqiptare dhe, së treti, alternativat e palës britanike në konferencë për zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Ky studim është mbështetur në dokumentet arkivore të Britanisë së Madhe, dhuruar nga studiues shqiptarë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, të cilat përfaqësojnë telegrame dhe letërkëmbime midis zyrtarëve britanikë të kohës, ku përmendet çështja shqiptare, sugjerimet për zgjidhjen e saj, si dhe qëndrimi ndaj saj në varësi të interesave britanike në rajon. Në këtë studim do të jemi të aftë t'i evidentojmë rezultatet që ka pasur qëndrimi britanik në çështjen shqiptare të kësaj periudhe. Gjithashtu, ndikimin që kanë pasur nismat zyrtare dhe jozyrtare të qeverisë britanike dhe se sa kanë ndikuar këto nisma në zgjidhjen e saj. Në bazë të shfrytëzimit të dokumentacionit arkivor do të mund t'i analizojmë efektet që ka pasur politika britanike mbi çështjen shqiptare në veçanti si dhe nëse ka pasur vërtet një nismë britanike për çështjen shqiptare.

Fjalë kyçe: Burime arkivore, arkiva për Shqipërinë, arkiva britanike, periudha e mesluftërave, histori e Shqipërisë

Mbarimi i Luftës së Parë Botërore shtroi nevojën e një riorganizimi të përgjithshëm të rendit ndërkombëtar. Programi ambicioz i presidentit amerikan W. Willson ngjalli shpresa të mëdha te njerëzit, për atë çfarë do të vinte pas luftës. Konferenca e Paqes në Paris i shërbente pikërisht këtij qëllimi: krijimit të një rendi të ri ndërkombëtar që do të shmangte një luftë të dytë të përmasave katastrofike si e para. Pas Luftës së Parë Botërore fuqitë fituese evropiane e shtruan përsëri për shqyrtim çështjen shqiptare, e cila kishte të bënte me statusin dhe tërësinë territoriale të saj. Periudha e pasluftës për Shqipërinë qe e mbushur me kërcënime të mëdha që vinin nga fuqitë aleate të luftës dhe nga fqinjët ballkanikë.¹ Çështja shqiptare u trajtua

¹ Pranvera Teli, *Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927* (Neraida, Tiranë, 2005), f. 36-37.

në kuadrin e rregullimit paqësor në mbarim të luftës. Ajo kaloi nëpër disa faza dhe u shqyrtua në forumet kryesore të pasluftës: në Konferencën e Paqes, Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e Ambasadorëve.² Një peshë kryesore për zgjidhjen e kësaj çështje mban Britania e Madhe. Pra, cili ishte kursi i diplomacisë angleze kundrejt çështjes shqiptare në tërësi dhe kufijve në veçanti?! Si ndikuan interesat e shteteve fqinje në qëndrimin britanik për një zgjidhje të drejtë të këtij problemi?! Për të hedhur dritë mbi këtë çështje na shërbejnë dokumentet dhe korrespondencat e kohës të zyrtarëve britanikë të kohës në Zyrën e Jashtme Britanike (Foreign Office) që ishin të angazhuar në çështjen shqiptare.

Më 18 janar 1919 në Paris u hap Konferenca e Paqes. Vëmendja e të gjithë botës ishte përqendruar atje. Instanca më e lartë vendimmarrëse ishte “Këshilli i të Katërve”, i përbërë nga presidenti amerikan W. Willson, i cili synonte ta vendoste paqen me programin e tij të njohur si “14 pikat”, kryeministri britanik L. George, kryeministri francez G. Clemenceau dhe kryeministri italian V. Orlando. Të gjitha shtetet që u ftuan në Konferencë, pavarësisht madhësisë, statutit dhe fuqisë, dërguan një delegacion zyrtar në Paris. Shqipërinë, ndryshe nga të tjerët, e përfaqësuan dy delegacione: ai i Qeverisë së Durrësit, i kryesuar nga T. Përmeti (ky delegacion mbështetej nga Italia), por edhe E. Toptani i vetëshpallur kryetar i qeverisë shqiptare. Por, përveç delegacionit të Durrësit që dallohej për prirjet e tij pro-italiane, pa përfshirë M. Konicën dhe M. Turtullin që i përkisnin orientimit anglo-amerikan, në Paris erdhën edhe delegacione nga diaspora shqiptare, nga Rumania, Turqia dhe ShBA-ja. Por, përveç delegacioneve shqiptare, çështja shqiptare pati edhe përkrahës nga zyrtarë dhe aktivistë anglezë të kohës, si A. Herbert, E. Durham, Lord Lamington, Lord Cecil etj., të cilët në këtë fazë ishin mjaft aktivë për çështjen shqiptare.³ Në memorandumun për situatën aktuale në Shqipëri, më 30 janar 1919, ndër të tjera, shprehej se delegacioni i Qeverisë së Durrësit kërkonte një mandat italian mbi Shqipërinë dhe se delegacioni shqiptar duhet të lejohej të paraqitej para Këshillit të të Katërve në konferencë. Gjithashtu, në këtë memorandum përshkruhej situata përgjatë kufijve tokësorë me fqinjët, në të cilën serbët dhe grekët kishin hyrë brenda kufijve.⁴ Më 12 shkurt 1919 delegacioni shqiptar, i kryesuar nga Turhan Pashë Përmeti, i paraqiti një memorandum Këshillit të Lartë, sipas të cilit, pavarësia e Shqipërisë quhej e fituar dhe e njohur ndërkombëtarisht me vendimet e 1913-s. Vëmendja e delegacionit u përqendrua edhe në ruajtjen e tërësisë territoriale sipas kufijve të vendosur

² Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore 1919-1926*, vëll. III (Albin, Tiranë, 2001), f. 7.

³ Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë (Toena, Tiranë, 2013)*, f. 374-375.

⁴ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme Britanike nr. 1510/1, Memorandum mbi situatën aktuale në Shqipëri, 30 janar 1919, f. 362-366 (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

më 1913. Delegacioni shqiptar doli para Këshillit të Lartë më 24 shkurt 1919, por iu kushtua pak vëmendje.

Çështja shqiptare në Konferencë, ndonëse nuk u trajtua më vete, zuri një vend të rëndësishëm në diskutimet e saj. Në këto çaste Shqipëria u gjend në një situatë delikate ndërkombëtare. Lufta e Parë Botërore e kishte vënë në rrezik ekzistencën e Shqipërisë, aq më tepër që vendi ishte kthyer në një shesh lufte. Për më tepër, ekzistonte Pakti i Fshehtë i Londrës i 1915-s, që parashikonte copëtimin e Shqipërisë, i firmosur nga Franca dhe Britania e Madhe në kuadrin e krijimit të aleancave. E vetmja shpresë për shqiptarët mbetej politika amerikane. Nga ana tjetër, Italia, Jugosllavia dhe Greqia u paraqitën në Konferencë me pretendimet e tyre të njohura ndaj Shqipërisë dhe bënë të gjitha përpjekjet për t'i realizuar ato. Pretendimet italiane në Adriatik, duke përfshirë edhe territoret shqiptare, bënë që çështja shqiptare të trajtohej në kuadrin e “Çështjes së Adriatikut”. Pretendimet italiane u bënë molla e sherrit për arritjen e një marrëveshjeje midis Këshillit të të Katërve. Kjo e vështirësoi zgjidhjen e çështjes shqiptare. Beogradi kërkonte Shqipërinë e 1913-s me qëllim shmangien e rrezikut italian pranë kufijve të mbretërisë së sapokrijuar. Nga ana e saj, Greqia, nëpërmjet Venizellosit, parashitroi pretendimet e saj për territoret e jugut të Shqipërisë.⁵ Në një kohë kur pretendimet e shteteve fqinje ishin të qarta, mbetej të shihej qëndrimi i Fuqive të Mëdha. Britania e Madhe, duke qenë e “lidhur” nga nënshkrimi i Traktatit të Londrës, e mendonte si zgjidhjen më të mirë midis të këqijave arritjen e një marrëveshjeje me Italinë për Shqipërinë. Në parlamentin anglez deputetë dhe anëtarë të Shoqërisë Anglo-Shqiptare, kjo e fundit e krijuar që në dhjetor 1912 për mbrojtjen e çështjes shqiptare, kërkonin që qeveria angleze ta konfirmonte qëndrimin që ajo kishte deklaruar që me njohjen e shtetit shqiptar me Traktatin e Londrës më 29 korrik 1913.⁶ Më 28 mars 1919, major Jameson pyeti në parlament nëse Konferenca e Paqes dhe qeveria angleze propozonin ta aplikonin parimin e vetëvendosjes për rastin e Shqipërisë. Duke shmangur përgjigjen e drejtpërdrejtë, përfaqësuesi i qeverisë angleze deklaroi në mënyrë krejt të paqartë duke u shprehur që në përcaktimin e kufijve në Evropën Juglindore, delegatët në Konferencën e Paqes po përpiqeshin në të gjitha rastet t'i mbanin parasysh dëshirat e popullatës së këtij rajoni.⁷ Më 28 prill 1920, Lord Lamington kërkoi që qeveria britanike ta merrte parasysh qëndrimin e saj duke pranuar parimin e një Shqipërie të pavarur dhe negociatat e zgjatura për çështjen e kufijve mbi të cilat u dakordua më 1913, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.⁸

Në fund të qershorit 1919 mbaron faza e parë e Konferencës së Paqes, në të cilin u trajtua çështja e Adriatikut verior. Po në këtë kohë Italia kaloi një

⁵ Pranvera Teli, *Shqipëria dhe diplomacia...*, f. 38-42.

⁶ Po aty f. 47.

⁷ AQSh, F. Ministria e Jashtme e Britanike, nr. 1510/1, V. 1921, D. 46, fl. 10.

⁸ Po aty, fl. 10.

krizë të brendshme politike pasi kabineti i V. Orlandos dha dorëheqje dhe në pushtet erdhi F. Nitti. Ky i fundit e ndërroi menjëherë politikën italiane me Shqipërinë dhe me qëllim që ta merrte përkrahjen greke për pretendimet italiane në një rajon tjetër, përfundoi me Greqinë më 29 korrik 1919 marrëveshjen Titoni-Venizellos. Publikimi i kësaj marrëveshjeje, që copëtonte shtetin shqiptar, ngjalli reagimin e përfaqësuesve shqiptarë në Konferencën e Paqes dhe jo vetëm, duke e konsideruar Italinë si një fqinje me të njëjtat qëllime si Serbia dhe Greqia. Britania e Madhe po e shikonte me mjaft interes Italinë dhe pretendimet e saj si kundërpeshë ndaj pretendimeve franceze në rajon dhe më gjerë.⁹ Jugosllavia kundërshtonte me forcë pretendimet italiane në Dalmaci dhe në këmbim të këtyre lëshimeve ajo kërkonte kompensime në Shqipëri, Shkodrën. Italianët nuk pranonin një lëshim të tillë, në një kohë që Shkodra ishte një nga qytetet kryesore. Kështu, marrëdhëniet midis Italisë dhe Jugosllavisë sa vinin e përkeqësoheshin. Më 6 gusht 1919, ministri i Jashtëm italian, Titoni, bëri disa propozime në Konferencën e Paqes në emër të qeverisë italiane. Në Dalmaci italianët braktisnin pretendimet e tyre dhe kërkonin që porti i Fiumes me territorin përreth të përbënin një shtet neutral. Për sa i përket Shqipërisë, italianët donin një mandat mbi Shqipërinë, kufijtë të mbetnin ata që ishin përcaktuar në vitin 1913, një marrëveshje midis Greqisë dhe Italisë, si dhe Vlora me pak rrethina t'i jepej Italisë nën sovranitet të plotë. Kryeministri anglez dhe ai francez e pranuan një mandat italian mbi Shqipërinë e 1913-s, me disa rregullime në Shqipërinë e jugut në favor të Greqisë e kundërshtoi disa lëshimeve që Italia bëri në Dalmaci. Përfaqësuesi amerikan Polk nuk e pranoi propozimin italian. Ai u shpreh se, përveç çështjes së mandatit për Shqipërinë, presidenti Willson, sipas tij, nuk pranonte propozimin për Fiumen, por kërkonte që Fiume të ishte një shtet i pavarur nën Lidhjen e Kombeve. Nëse do të pranohej kjo dhe disa rregullime të tjera në Adriatikon Verior, delegacioni amerikan do të përpiqej ta bindte presidentin Willson ta pranonte zgjidhjen, përfshirë edhe mandatin italian mbi Shqipërinë.¹⁰ I prirë për të dalë nga pikat e Traktatit të Londrës, Nicolson ra dakord me këtë qëndrim amerikan, pavarësisht se ai e quante një shtrirje të pajustificueshme në hinterlandin e Vlorës, por ai nuk u shpreh asnjëherë në konferencë për këtë.¹¹

Gjatë gjithë vitit 1919 informacionin kryesor për zhvillimin e ngjarjeve në Shqipëri, Londra zyrtare e merrte nga gjeneral Philips, kryetar i misionit britanik ushtarak në Shkodër që prej dhjetorit të vitit 1918. Më 24 tetor 1920, në një telegram Philips e informonte FO mbi bisedën me gjeneral Fourtoun, ku ky i fundit shprehej se i kishte shkruar qeverisë franceze që çështja shqiptare meritonte vëmendje të menjëhershme, se pavarësia duhej

⁹ Pranvera Teli, *Shqipëria dhe diplomacia...*, f. 48-50.

¹⁰ Po aty f. 55.

¹¹ Po aty f. 55.

garantuar, asnjë pjesë territori shqiptar nuk duhej t'i jepej Serbisë, Greqisë apo Italisë. Gjithashtu, Philips vinte në dukje se shqiptarët ishin gjithmonë e më të bashkuar. Ndërkohë, trupat serbe dhe malazeze kishin hyrë sërish në Vermosh dhe kishin okupuar tre qytete të vogla në fiset e Kelmendit dhe të Shkrelit. Më tej Philips informon se shqiptarët e kishin penguar depërtimin e këtyre trupave. Për më tepër që dy batalione italiane kishin zbarkuar në veri dhe pritej që së shpejti të mbërrinin mjete ushtarake. Sipas Philipsit, nuk kishte dyshim që urrejtja ndaj Italisë ishte rritur më shumë në jug sesa në veri dhe se mandati italian ishte një propozim i pashpresë në një kohë që edhe francezët për shkak të qëndrimit pro-serb mund të kishin përplasje me italianët që kërkonin mandatin mbi Shqipërinë. Sipas Philipsit, tërheqja e trupave britanike nga Shkodra do të çonte në një përplasje midis italianëve dhe francezëve.¹² “Tërheqja e gjithë trupave nga Shqipëria - shprehej Philips - kam frikë se do të ketë efekte serioze te shqiptarët. Nuk mendoj se shqiptarët kanë ndonjë shpresë për ndërhyrjen britanike, në të cilën ata kanë mbështetur dëshirën e tyre, por për sa kohë që në vend janë ende një numër i vogël burrash anglezë me uniformë, ata besojnë se Anglia, të cilën në aspektin e drejtësisë e vendosin mbi të gjitha shtetet, ishte më së paku duke u kujdesur për ta”.¹³

Një informacion të rëndësishëm FO merrte nga Aubrey Herbert, anëtar parlamenti dhe përkrahës i flaktë i çështjes shqiptare. Në fillim të korrikut A. Herberti shtroi një pyetje në parlamentin anglez, nëse aleatët kishin ndërmend të krijonin një shtet të lirë dhe të pavarur shqiptar, apo do të copëtonin atë, siç ishte copëtuar Polonia. Nënkretari i shtetit për Punët e Jashtme, Cecil Harmsworthi, u përgjigj se kjo çështje nuk ishte diskutuar nga Këshilli i Lartë në Paris.¹⁴ Ndërkohë në Shqipëri ndodhej edhe Eden, i cili nga dokumentet angleze paraqitet si i punësuar nga Ministria e Luftës, si përkthyes në Shqipërinë e jugut. Në një kohë kur flitej për një mandat italian dhe për ta pasur nën sovranitetin e tyre Vlorën, Eden kërkonte në FO që italianëve u duhej bërë e qartë se nuk mund ta mbanin Vlorën, përveçse me forcë, pasi Vlora ishte e rrethuar me kodra dhe se shqiptarët do të ishin në gjendje të siguronin artileri nga serbët dhe grekët. Sipas Eden, për sa i përket mandatit, shqiptarët do të pranonin ose një mandat të Britanisë së Madhe, ose atë amerikan. Presidenti Willson e aprovoi qëndrimin e delegacionit amerikan në Paris për problemin e Fiumes, gjithashtu shprehej pa dëshirë

¹² AQSh, F. Ministria e Jashtme e Britanike nr. 1510/1, informacion i gjeneral Philipsit për Foreign Office, 24. 10. 1920, f. 478-481 (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

¹³ AQSh, F. Ministria e Jashtme e Britanike nr. 1510/1, informacion i gjeneral Philipsit për Foreign Office, 24.10.1920, f. 482. (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

¹⁴ Bejtullah Destani dhe Jason Tomes, *Miku i madh i shqiptarëve. Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë moderne. Ditarë dhe letra 1904-1923*, përkthyer nga Kastriot Myftari (*Via Egnatia*, Tiranë, 2012), f. 328.

për një mandat italian mbi Shqipërinë në kushte të mirëpërcaktuara. Edhe pse qeveria franceze dhe ajo britanike ishin kundër propozimit amerikan për veprime në Adriatik, kjo e fundit preferonte të mos ishte nismëtare për veprime të tilla, por as të nxirrte pengesa kur të tjerët ofrojnë një propozim për kompromis. Iniciativa individuale do ta dëmtonte marrëdhënien e Britanisë me Italinë. Si rezultat i bllokimit të çështjes së Adriatikut, përfaqësuesi amerikan propozoi që diskutimi për kufijtë e Shqipërisë të ndahej nga çështja e Adriatikut. Pala italiane e përkrahu këtë propozim me kusht që të mos e ndante çështjen e mandatit italian mbi Shqipërinë nga çështja e Adriatikut. Në këtë pikë pala britanike nuk e përkrahu propozimin amerikan dhe atë italian. Ky qëndrim i britanikëve po e komplikonte më tepër pozicionin e saj në diskutimin e çështjes së Adriatikut. Nga njëra anë ajo preferonte të ishte pro propozimeve amerikane, që të mos i binte ndesh një fuqie të madhe nga e cila priste ndihmë ekonomike prej gjendjes së vështirë të pasluftës, si dhe përpiqej t'u shmangej pretendimeve italiane në Adriatikun lindor, të cilat i jepnin mundësi në lindje, por duke dashur ta kishte Italinë përkrah vetes për baraspeshë kundrejt pretendimeve franceze në Evropë, Britania e Madhe u përpoq të ndryshonte diçka në kursin e saj. Ll. George me anë të një telegrami të 10 tetorit 1919 për herë të parë kërkon hapur të Willsoni pranimin e kërkesave italiane por, pavarësisht prej kësaj ndërhyrjeje, presidenti dhe delegacioni amerikan nuk ndryshuan nga qëndrimi i tyre.

Nga informacionet që vinin prej gjeneralit Philips në Shqipëri, FO ishin dakord me opinionin e përgjithshëm të tij se çdo hap që synonte ruajtjen e paqes në Shqipëri e meritonte të inkurajohej, por nga ana tjetër Curzon e Crowe shprehnin dyshime serioze nëse qeveria britanike duhej ta përkrahte apo të lejonte që të krijoheshin përshtypja se ato përkrahnin grupimet që ishin krijuar kundër pretendimeve serbe dhe italiane ndaj territoreve shqiptare. “Unë do të merrja guximin – shkruan Curzon për Philips – t’i kujtoja zotërisë tuaj që, mirë ose keq, drejt apo gabim, qeveria britanike ka lejuar qeverinë italiane për të besuar se ekziston çdo gatishmëri nga ana e qeverisë britanike për të përkrahur një mandat italian në Shqipëri.”¹⁵ Pavarësisht se qeveria britanike e kishte të qartë që shqiptarët do ta kundërshtonin një mandat italian, nga njëra anë ajo ishte e implikuar prej Traktatit të Fshehtë të Londrës dhe nga ana tjetër ky mandat ishte i nevojshëm në këmbim të disa lëshimeve nga ana e Italisë, për më tepër që një mandat i tillë ishte pranuar nga presidenti Willson. Kështu, qëndrimi zyrtar britanik ishte më tepër pasiv sesa aktiv për çështjen shqiptare. Britania ndiqte ende parimin e ekuilibrit të forcave në Këshillin e të Katërve. Edhe kur pala italiane nuk pranonte të negocionte pretendimet e saj në Shqipëri, qeveria britanike e kishte të vështirë të mbante një qëndrim të prerë ndaj kërkesave italiane,

¹⁵ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme Britanike nr. 1510/1, 03. 11. 1919. (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

ashtu siç kërkonte qeveria amerikane. Në këtë mënyrë Londra zgjodhi rrugën e ndërmjetësimit midis qeverisë amerikane dhe asaj italiane për çështjen e Adriatikut. Kështu, më 9 dhjetor 1919 Britania e Madhe, Franca dhe ShBA-ja dolën me një memorandum të përbashkët. Nëpërmjet këtij memorandumit Italia arrinte të realizonte gati krejt planet e saj për Shqipërinë. Së pari ajo merrte mandatin mbi Shqipërinë, sovranitet të plotë mbi Vlorën dhe hinterlandin e saj. Nga ky memorandum përfitonte edhe Greqia pasi lihej e hapur çështja e kufirit jugor. Jugosllavia do ta kishte të drejtën të ndërtonte dhe të shfrytëzonte vija hekurudhore në Shqipërinë Veriore. Parashikohej edhe një “kontroll mbi zhvillimin e Bunës”, që mund të ushtrohej në bashkëpunim midis Italisë dhe Jugosllavisë. Në fakt, ky memorandum shënonte një prapakthim për çështjen shqiptare dhe ngjalli reagimin e shqiptarëve dhe jo vetëm.¹⁶ Megjithatë, as memorandum i 9 dhjetorit nuk i pajtoi interesat italo-jugosllave. Kështu, Anglia dhe Franca ndërmorën iniciativën për ta zgjidhur çështjen e Adriatikut mbi bazën e copëtimit të Shqipërisë. Për qeverinë britanike ishte e qartë se asnjë përparim nuk mund të bëhej nëse çështja nuk diskutohej në tërësinë e saj, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Italia sërish paraqiti pretendimet e saj për liri veprimi si në çështjen e mandatishtit ashtu edhe të kufijve.¹⁷

Më 14 janar 1920 u arrit një marrëveshje midis kryeministrit të Francës, të Anglisë dhe të Italisë, pa marrë pëlqimin e qeverisë amerikane. Në bazë të kësaj marrëveshjeje u arrit në kompromisin që Fiume dhe Zara të shpallehin si njësi të pavarura nën garancinë dhe mbikëqyrjen e Lidhjes së Kombeve. Për sa i përket Shqipërisë, në kundërshtim me bisedimet gjatë punimeve të konferencës, ku u pranua pikëpamja e presidentit Willson për pavlefshmërinë e Traktatit të fshehtë të Londrës, “akordi” rikthehej te ky traktat. Kështu, Italia merri nga Lidhja e Kombeve mandatin mbi Shqipërinë, veriu i kalonte Jugosllavisë bashkë me Shkodrën, Shëngjinin dhe luginën e Drinit. Ndërsa jugu me Korçën dhe Gjirokastrën i liheshin Greqisë. Kjo marrëveshje ishte në dëm të shtetit shqiptar duke e copëtuar dhe duke e vënë pjesën që mbetej nën një mandat të huaj. Pas publikimit të kësaj marrëveshjeje, qeveria amerikane paralajmëronte se nuk do të njihnte asnjë vendim që do të ishte në kundërshtim të pikëpamjeve të saj¹⁸, ndërsa Londra dhe Parisi shfaqësoshin se, për sa i përkonte Shqipërisë, ishte bërë një përpjekje për t’i kënaqur nevojat kryesore të të gjitha palëve të interesuara.¹⁹ Politika britanike, në këtë fazë në të cilën ndodhej çështja shqiptare, ishte tepër dekurajuese, pasi e shikonte çështjen në tërësi me çështjen e Adriatikut. Marrëveshja e 14 janarit ishte një prapakthim i qëndrimit të Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë. Për më tepër që pala

¹⁶ Arben Puto, *Shqipëria politike*, (Toena, Tiranë, 2009), f. 202-203.

¹⁷ Po aty f. 202.

¹⁸ Po aty f. 204-205.

¹⁹ Pranvera Teli, *Shqipëria dhe diplomacia...*, f. 83.

angleze kishte rënë dakord t'i lëshonte Shkodrën shtetit jugosllav. Gjatë diskutimeve të shumta në parlament më 12 shkurt 1920, A. Herberti pyeti nëse ai, kryeministri Ll. George, kishte ndikuar për copëtimin e Shqipërisë dhe në qoftë se kjo vazhdoi të këmbëngulte që Shqipëria ishte njohur si shtet i pavarur. Më pas Herberti bëri të ditur se Ll. George i kishte ofruar Jugosllavisë pjesën veriore, italianëve pjesën qendrore, ndërsa grekëve pjesën jugore të Shqipërisë. Gjatë fjalës së tij në parlament ai argumentoi se një politikë e tillë e ndjekur nga Britania e Madhe ishte shkelje e besimit dhe tradhti ndaj premtimeve që britanikët kishin bërë më parë.²⁰

Kundërpërgjigja amerikane nuk vonoi të vinte. Me notën e 25 shkurtit 1920 presidenti Willson ripohoi qëndrimin e tij kundërshtues ndaj marrëveshjes së 14 janarit që ishte arritur pa konsultimin e palës amerikane. Gjithashtu, ajo (qeveria amerikane) kundërshtonte një zgjidhje që do mund të dëmtonte shqiptarët në favor të jugosllavëve, si dhe çdo zgjidhje që mund t'i cenonte jugosllavët në përfitim të Italisë. Në notën e 6 marsit, presidenti Willson kërkoi që çështja shqiptare të lihej jashtë çështjes së Adriatikut. Në këto çaste Shqipëria u gjet në një rrethanë të favorshme ndërkombëtare pasi doli si një çështje që duhej diskutuar më vete. Ndërkohë Ll. George, i lodhur nga përpjekjet e dështuara për të gjetur një zgjidhje të problemeve në Adriatik, filloi t'i quante të kota bisedimet pa praninë e palës jugosllave. Me gjithë përpjekjet që u bënë, delegacioni shqiptar që shkoi në Londër në mars 1920 (Konica-Fishta-Bumçi) nuk u prit nga Lordi Curzon dhe nuk mori asnjë mesazh zyrtar në mbështetje të qeverisë shqiptare. Me gjithë përpjekjet e A. Herbert për t'i nxitur qarqet e larta qeveritare e diplomatike britanike që të njihnin *de jure* dhe *de facto* qeverinë shqiptare, politika zyrtare britanike kishte ecur një hap me politikën franceze për çështjen shqiptare në Konferencën e Paqes.²¹ Gjatë një seance në Dhomën e Komunëve, pyetjes së një deputeti nëse pavarësia e Shqipërisë ishte garantuar dhe nëse qeveria britanike do ta ndihmonte Shqipërinë për ta siguruar integritetin territorial dhe pavarësinë politike, Ll. George iu përgjigj se nacionalizmi shqiptar kishte gjithë simpatinë e qeverisë britanike, por ajo (qeveria britanike) nuk ishte në kushte për ta deklaruar, se këto ishin drejtpërsëdrejti interesat e shteteve të tjera aleate.²²

Konferenca e Parisit i mbylli zyrtarisht punimet më 10 prill 1920. Falë këmbënguljes amerikane çështja shqiptare u la jashtë çështjes së Adriatikut. Në këtë kohë ndryshimi i qeverisë italiane u shoqërua edhe me një ndryshim kursi në drejtim të çështjes shqiptare. Gioliti u shpreh se nuk donte një mandat mbi Shqipërinë dhe se vendi i tij do të ishte kënaqur me Vlorën. Heqja dorë prej Italisë të një mandati italian në Shqipëri i dha dorë qeverisë britanike për ta ndryshuar politikën indiferente ndaj çështjes shqiptare,

²⁰ AQSh, F. Aubrey Herbert nr. 737, pa vit, D. 7, fl. 1.

²¹ Paskal Milo, *Politika...*, f. 473-475.

²² *Lloyd George për nacionalizmin shqiptar, Zani i ri*, Tiranë, nr. 3 (1920), f. 2.

sidomos të sigurimit të tërësisë territoriale. Në prill 1920 në FO vjen lajmërimi për pushtimin e Korçës nga grekët. Venizellosi u porositi që t'i tërhiqte trupat deri në një vendim final për Shqipërinë. "Qeveria e Madhërisë së Tij nuk mund të aprovojë një pushtim të tillë, kur e tërë çështja shqiptare është në shqyrtim – i deklaronte Curzon Venizellosit".²³ Më 28 maj u firmos protokoll i Kapshticës me qeverinë greke. Nga ana tjetër në qershor 1920 kishin filluar kryengritjet shqiptare kundër forcave italiane të pushtimit afër Vlorës. Lufta e Vlorës zgjati deri më 2 gusht 1920. Më 3 shtator 1920 trupat italiane u larguan përfundimisht nga Shqipëria. Tërheqja erdhi edhe si rezultat i trazirave të brendshme në Itali. Ndërkohë, në veri vazhdonte avancimi i trupave jugosllave në territorin shqiptar. Qeveria britanike i kërkoi qeverisë jugosllave t'i tërhiqte trupat deri kur të kishte një vendim përfundimtar për çështjen shqiptare. Nënshkrimi i marrëveshjes së Rrapallos, më 12 nëntor 1920 midis Italisë dhe Jugosllavisë, si dhe protokoll i Kapshticës krijuan një situatë të favorshme ndërkombëtare për çështjen shqiptare.²⁴

Gjatë kësaj kohe qeveria shqiptare nuk i ndaloi përpjekjet për njohjen e qeverisë dhe integritetit tokësor të Shqipërisë si dhe të pranohej në Lidhjen e Kombeve. Nga ana e tij, A. Herberti, në një telegram që i dërgon qeverisë shqiptare më 4 tetor 1920, shkruante se kishte biseduar me H. Nicolsonin në Foreign Office dhe kishte kërkuar me ngut që qeveria britanike të njihje qeverinë shqiptare. Sipas Herbertit, Nicolsoni ishte mjaft dashamirës me këtë sugjerim dhe e kishte siguruar Herbertin mbi pretendimet greke dhe serbe në Shqipëri.²⁵ Po ashtu, në një telegram tjetër dërguar kreut të qeverisë shqiptare, Herberti sugjeronte që qeveria shqiptare ta telegrafonte kërkesën për pranim për anëtarësim në Lidhjen e Kombeve.²⁶ Më 12 tetor 1920 Pandeli Evangjeli, kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes, i dërgoi zyrtarisht Sir E. Drummondit, sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, kërkesën që Shqipëria të bëhej anëtare e Lidhjes së Kombeve.²⁷ Shoqëria Anglo-Shqiptare do të aktivizohej sërish për të lobuar për pranimin e një kërkesë të tillë, në mënyrë që Shqipëria të bëhej anëtare me të drejta të plota pranë kësaj organizate. Më 19 tetor, A. Herberti do t'i shkruante Sir E. Drummondit mbi kërkesën për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, duke kërkuar që Shqipëria të trajtohej njëjloj si shtetet e tjera të vogla të cilat kohët e fundit ishin pranuar në Lidhjen e Kombeve.²⁸

²³ Pranvera Teli, *Shqipëria dhe diplomacia...*, f. 97.

²⁴ Po aty f. 102.

²⁵ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme, nr. 151, V. 1920, D. 33, fl. 27.

²⁶ Po aty fl. 28.

²⁷ Owen Pearson, *Albania and King Zog*, Vol. I (I B Tauris & Co Ltd, London, 2001), f. 111.

²⁸ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme nr. 151, V. 1920, D. 33, fl. 38.

A. Herbert do të vazhdonte të ushtronte trysni pranë qarqeve britanike. Në një letër që A. Herbert i dërgonte një Siri, emri i të cilit nuk bëhet me dije, shkruante se shqiptarët donin të anëtarësoheshin në Lidhjen e Kombeve dhe do të ishte e nevojshme që të kishin një përfaqësues që të ishte i pranishëm në Asamblenë në Gjenevë. Gjithashtu, ai shkruante se do të kontaktonte me Balfourin, Fischerin dhe Barnesin mbi Shqipërinë dhe se shpresonte ta kishte edhe mbështetjen e Dhomës së Komunëve për çështjen shqiptare.²⁹ “Në qoftë se ju doni stabilitet në Ballkan, - i shkruante A. Herbert në nëntor C. Harmsworth - mes gjërave të tjera të mëdha, ju duhet ta bëni fakt pozicionin që ju i keni garantuar Shqipërisë në letër dhe jo të insistoni në trajtimin e Shqipërisë dhe të qeverisë shqiptare si një subjekt i nxjerrë jashtë ligjit”.³⁰ A. Herbert e shtroi çështjen e pranimin të Shqipërisë edhe në parlamentin anglez. Komiteti Anglo-Shqiptar do të vazhdonte të insistonte pranë qarqeve britanike për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Por për të qenë anëtare e kësaj organizate Shqipërisë iu kërkua të paraqiste dy kopje dokumentesh: i pari një kopje autentike e dokumenteve përmes të cilave ajo kishte marrë vetëqeverisjen e plotë dhe i dyti kopje autentike të deklaratave përmes të cilave qeveri të tjera kishin njohur qeverinë shqiptare *de jure* dhe *de facto*.³¹

Vetëm më 17 dhjetor 1920 Asambleja e Përgjithshme mori në shqyrtim kërkesën e Shqipërisë. Asambleja votoi për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Në këtë mënyrë Shqipëria bëhej vendi i parë që i bashkohej një organizate ndërkombëtare pa siguruar më parë njohje diplomatike. Pas propozimit të Lord Robert Cecilit, Asambleja futi çështjen e përfaqësuesve shqiptarë pranë Lidhjes së Kombeve të cilët ishin: Dr. Adhamidhi, Fan Noli, Pandeli Cale dhe Hilë Mosi.³² Më 18 dhjetor, Foreign Office njoftonte se diplomati anglez Eyres do të shkonte në Shqipëri në cilësinë e kryekonsullit. Kthesa britanike ndaj çështjes shqiptare qe enigmatike, por me kalimin e kohës filluan të shtroheshin disa hipoteza. Por mendohet se interesi ekonomik, synimet gjeopolitike, roli i opinionit publik dhe padyshim i miqve të Shqipërisë ishin arsytet që ndryshuan qëndrimin britanik.³³ Me pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, nga pikëpamja britanike do të thoshte se pavarësia dhe sovraniteti i Shqipërisë ishin vendosur *de facto*. Në fakt, pranimi në këtë organizatë ndërkombëtare kishte rëndësi të dyfishtë: së pari përmes pranimin ripohohej njohja ndërkombëtare e shtetit shqiptar; dhe, së dyti, ai merrte vlerën e njohjes kolektive të qeverisë shqiptare.³⁴

²⁹ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme, nr. 151, V. 1920, D. 33, fl. 39.

³⁰ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme Britanike nr. 1510/1, 02. 11. 1920 (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

³¹ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme nr. 151, V. 1920, D. 33, fl. 51.

³² *Drita*, Gjirokastrë, 26, (1920), f. 3.

³³ Paskal Milo, *Politika...*, f. 515.

³⁴ Pranvera Teli, *Shqipëria dhe diplomacia...*, f. 130.

Pranimi në Lidhjen e Kombeve hapi rrugën për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Tashmë, problem i vetëm për t'u zgjidhur ishte njohja dhe garantimi i tërësisë territoriale të vendit. Pretendimet fqinje ishin të njohura. Etapa e dytë dhe përfundimtare drejt rinjohjes së shtetit shqiptar ishte Konferenca e Ambasadorëve në nëntor 1921. Kjo konferencë ishte vazhduese e Konferencës së Paqes për zgjidhjen e çështjeve që dilnin nga zbatimi i traktateve të Versajës dhe për çështjet që nuk kishin gjetur zgjidhje në konferencë. Gjatë kësaj kohe çështja e kufijve të Shqipërisë ishte ajo që mernte rëndësi për zgjidhje. Qeveria italiane, edhe pas tërheqjes së trupave nga Vlora, u përpoq t'i siguronte këto të drejta në arenën ndërkombëtare duke kërkuar mbështetjen e Britanisë së Madhe. Më 9 mars 1921, ambasadori italian në takimin me Crowe kërkoi të dinte nëse qeveria britanike ishte e gatshme që t'i përgjigjej kërkesës italiane për një deklaratë të përbashkët apo për përdorimin e instrumenteve të tjera të përbashkëta ndaj Shqipërisë. Më 20 prill 1921 Curzoni i ktheu përgjigje ambasadorit italian se: "Qeveria e Lartmadhërisë së Tij pajtohej plotësisht me dëshirën e qeverisë tuaj për të bashkëpunuar për krijimin e një shteti autonom e të pavarur të Shqipërisë, por ato e konsiderojnë se ekzistenca ndërkombëtare e këtij vendi dhe përcaktimi i kufijve të tij përbëjnë një çështje të shqetësimit ndërkombëtar që mund të trajtohet vetëm nga fuqitë kryesore aleate që veprojnë në konferencë... pavarësisht nga sa më sipër, prapë unë nuk jam i gatshëm t'i njoh Italisë ndonjë interes të veçantë në këtë vend".³⁵

Për sa kohë kufijtë e Shqipërisë nuk ishin përcaktuar akoma, situata në Shqipëri po rëndohej për shkak të ndërhyrjes së fqinjëve. Për këtë Londra propozoi që Konferenca në fillim t'i përcaktonte kufijtë dhe më pas t'i akordohej Shqipërisë njohje zyrtare. Nga ana e saj qeveria shqiptare, përmes delegacionit të saj në Lidhjen e Kombeve dhe përfaqësuesve në Paris, vazhdonte t'ua tërhiqte vëmendjen Fuqive të Mëdha dhe Lidhjes së Kombeve për situatën e vështirë që ishte krijuar për Shqipërinë, si nga mosnjohja e qeverisë së saj, ashtu edhe nga ngjarjet që po zhvilloheshin në kufirin me Serbinë dhe Greqinë.³⁶ Incidentet e shkaktuara nga grekët në jug dhe veprimet e serbëve në Kosovë e Dibër janë rastet në fjalë. Arsyeja kryesore pse qeveria britanike këmbëngulte për të diskutuar për çështjen e kufijve të Shqipërisë në Konferencën e Ambasadorëve ishte Traktati i Londrës i vitit 1915, sipas të cilit, Shqipëria i jepej Italisë.

Më 25 qershor 1921 Këshilli i Lidhjes së Kombeve do të mblidhej për ta diskutuar kërkesën e delegacionit shqiptar të 21 qershorit 1920 për rinjohjen e kufijve të 1913-s, të pranuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe largimi nga brenda kufijve territorialë të ushtrive greke dhe jugosllave,

³⁵ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme Britanike nr. 1510/1. (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

³⁶ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme Britanike nr. 1510/1. (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

çka gjatë kësaj kohe krijoi të ashtuquajturin “konflikt i kompetencave”. Nga njëra anë qeveria shqiptare, nëpërmjet kryetarit të delegacionit shqiptar, Fan Noli, e shtroi çështjen përpara Këshillit të Lidhjes dhe kërkoi ndërhyrjen e organizatës në bazë të artikujve 11 dhe 15 të paktit, për zbrazjen e territorit shqiptar të okupuar nga trupat e huaja dhe mbrojtjen e kufijve të saj të 1913-s. Konferenca e Ambasadorëve konsiderohej jokompetente për caktimin e këtyre kufijve, përderisa Shqipëria kishte qëndruar neutrale gjatë luftës. “Kam frikë – shprehej Crowe – që Lidhja e Kombeve do të vihej në vështirësi në qoftë se pritej ta merrte Traktatin e Londrës në zgjidhjen e saj finale. Përveç kësaj, Konferenca e Ambasadorëve ka më shumë gjasë ta trajtojë këtë çështje si një lloj biznesi, ndërkohë që një komision i Lidhjes së Kombeve, sipas praktikave të fundit, përbëhet nga ekspertë brazilianë, kinezë dhe ekspertë të tjerë ekzotikë që janë krejtësisht jashtë këtij traktati”.³⁷ Pavarësisht prej pretendimeve të secilës palë, çështja e kufijve të Shqipërisë u la të trajtohej nga Konferenca e Ambasadorëve. Ndërkohë, shqiptarët vazhduan protestat e tyre ndaj këtij vendimi. Nga ana tjetër, Eyres njoftonte në FO se Shqipëria ishte e gatshme të bënte koncesione, por asgjë nuk mund të arrihej nëse Italia nuk hiqte dorë nga kërkesat e saj për bazë detare në Vlorë. Më 9 korrik 1921, në memorandumun e Ambasadës Britanike në Paris drejtuar Konferencës së Ambasadorëve, thuhej se Ambasada Britanike e ka informuar qeverinë britanike mbi deklaratën e bërë nga ambasadori italian në takimin e Konferencës së Ambasadorëve më 29 qershor lidhur me interesat e posaçme në Shqipëri të deklaruara nga qeveria italiane. Gjithashtu, në këtë memorandum ambasada shprehej se ishin të udhëzuar nga qeveria britanike të shpreheshin se nuk kishin ndonjë kërkesë të veçantë në emër të tyre në lidhje me statusin e ardhshëm të Shqipërisë dhe se qeveria britanike nuk është e gatshme të njohë çdo interes të veçantë të ndonjë vendi tjetër në Shqipëri.³⁸

Në memorandumun drejtuar Konferencës së Ambasadorëve më 20 korrik 1921, Ambasada Britanike në Paris shprehej se sikurse Konferenca ishte e ndërjegjeshme, dhjetorin e kaluar (1920) Këshilli i Lidhjes së Kombeve pranoi Shqipërinë si anëtare e lidhjes pa paragjykime për çështjen e kufijve. Sipas qeverisë britanike, pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve ka përcaktuar një herë e mirë çështjen e statusit ndërkombëtar të vendit, për më tepër që gjatë luftës ka qenë një shtet i pavarur si dhe është pranuar në Lidhjen e Kombeve pa ndonjë rezervim për pavarësinë e saj. Në memorandum thuhej se Shqipëria kishte hyrë në Lidhjen e Kombeve dhe ishte njohur nga shtetet anëtare si shtet i pavarur. Për më tepër, për të njëjten

³⁷ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme Britanike nr. 1510/1. (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

³⁸ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme Britanike nr. 1510/1, memorandum i Ambasadës Britanike në Paris drejtuar Konferencës së Ambasadorëve, 9 korrik 1921, f. 143. (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

arsye, pas pranimi të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, është e pamundur që ndonjë shtet të pretendojë të drejta apo interesa të veçanta mbi këtë vend, në një kohë që këto pretendime apo interesa nuk u shfaqën kur Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve.³⁹ Ndër të tjera, në memorandum thuhej: “Qeveria britanike ka nderin të ftojë Konferencën të pranojnë pikëpamjen se me pranimin në Lidhjen e Kombeve, si shtet, *ipso facto* Shqipëria është një shtet Sovran dhe i pavarur, edhe pse Lidhja shprehimisht i la kufijtë të papërcaktuar. Kështu, statusi ndërkombëtar i Shqipërisë është i përcaktuar dhe çdo përfundim në të cilin do të dalë Konferenca, ai duhet të bazohet në këtë supozim. Në këto rrethana, i vetmi aspekt i statusit të Shqipërisë, të dallueshme nga kufijtë, ku vendimi i Konferencës do të jetë i domosdoshëm, do të jetë në lidhje me formën e njohjes me të cilën aleatët do të vendosin marrëdhëniet e tyre me Shqipërinë. Për shembull, sapo Konferenca të ketë caktuar kufijtë e Shqipërisë, qeveritë aleate duhet të përcaktojnë qëndrimin e tyre nëpërmjet një protokolli, traktati apo vendosjes së përfaqësuesve diplomatikë në Shqipëri”.⁴⁰

Duke parë situatën e krijuar midis pretendimeve italiane dhe diskutimit të çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve, në korrik 1921, Crowe, i përkrahur edhe nga Curzon, propozonte që “...politika jonë më e mirë do të ishte që ta lemë Konferencën e Ambasadorëve të kufizonte veten vetëm tek çështja e kufijve dhe të insistojmë që çdo çështje tjetër, siç është edhe statusi i Shqipërisë apo të drejtat e Italisë mbi këtë rajon, të trajtohen nga Lidhja e Kombeve, ku Shqipëria mund t’i dalë zot vetes së saj”.⁴¹ Po në këtë datë filloi punën Komiteti i Ekspertëve për kufijtë e Shqipërisë. Që në takimin e parë, Temperley, përfaqësues anglez në komitet, këmbëngulte që diskutimi të fillonte me çështjen e kufijve. Përballë pretendimeve greke për territoret në jug të Shqipërisë, Temperley i kërkoi delegacionit grek të sillnin fakte për situatën etnike, e gjuhësore për qytetin e Korçës dhe Gjirokastrës. Para se këto të dhëna të vinin nga qeveria greke, Eyres informonte FO për karakterin etnik e gjuhësor shqiptar të këtyre trevave.⁴²

Situata në kufijtë e Shqipërisë vazhdonte të ishte problematike, por edhe trysnia e qeverisë italiane për të pasur të drejta mbi Shqipërinë e rëndonte situatën. Me qëllim zhbllokimit të situatës, FO nëpërmjet Hardinge i dërgoi një memorandum sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes Kombeve, ku udhëzonte t’i komunikonte lidhjes vendimin e komitetit të ekspertëve për kufijtë e Shqipërisë. Për këtë FO i dërgoi një telegram qeverisë italiane duke

³⁹ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme Britanike nr. 1510/1, Memorandum për Konferencën e Ambasadorëve, 20 korrik 1921, f. 144. (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

⁴⁰ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme Britanike nr. 1510/1, memorandum për Konferencën e Ambasadorëve, 20 korrik 1921, 144-145. (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

⁴¹ Pranvera Teli, *Shqipëria dhe diplomacia*, f. 154.

⁴² Po aty f. 161.

e vënë atë para një fakti të kryer. Në memorandumun e datës 26 gusht 1921, që i propozojë Lord Curzon për ambasadorin italian, thuhej: “Çështja është se nuk duam ta refuzojmë kërkesën italiane, por si të formulojmë një refuzim për të ngjallur sa më pak zemërim. Më poshtë sugjerojmë elementët e një replike: 1. Marrëveshje mbi nevojën për të siguruar pavarësinë e Shqipërisë dhe gatishmërinë tonë për të marrë në konsideratë çdo formulë që shprehimisht garanton garanci ndërkombëtare nën Lidhjen e Kombeve të integritetit të Shqipërisë. 2. Konsideratën për vështirësitë strategjike të Italisë në Adriatik dhe gatishmëria jonë për të marrë në konsideratë çdo formulë për neutralizimin dhe çmilitarizimin e vijës dhe porteve shqiptare. 3. Për sa i përket Sazanit, tërheqim vëmendjen se Shqipëria është pranuar në Lidhjen e Kombeve jo vetëm si shtet i pavarur, por edhe Sovran, dhe lidhur me këtë Shqipëria si shtet Sovran ka të drejtë të përcaktojë dhe të rregullojë marrëdhëniet e saj me shtetet e tjera. Në këtë kuadër mund të citojmë deklaratën e Giolittin në Këshilli, në të cilin formalisht deklaronte se Italia njihnte sovranitetin e Shqipërisë dhe fjalimin e mbajtur nga delegati italian në takimin e Asamblesë së Lidhjes së Kombeve. Nëse Italia do të donte të impononte ndonjë pretendim mbi sovranitetin e Shqipërisë, ajo duhet të kishte shfaqur rezervat e saj në asamblenë e lidhjes. Ajo (Italia) nuk shfaqti pretendime të tilla dhe fuqitë e tjera e interpretojnë sovranitetin e Shqipërisë, sipas rregullave të ligjit ndërkombëtar. Ne mund të konkludojmë një ripohim të pa interesuar politikisht në Shqipëri dhe me garancinë se do të mirëpresim çdo marrëveshje në të cilën Shqipëria dhe Italia do të kenë marrëdhënie të përbashkëta”.⁴³

Lidhja e Kombeve e filloi diskutimin e kufijve shqiptarë më 14-15 shtator 1921. Përfaqësuesi italian deklaroi se nuk e njihnte vendimin e Komitetit të Ekspertëve, pasi nuk ishte vendim i Konferencës së Ambasadorëve, dhe paraqiti kërkesën e qeverisë së tij për Sazanin dhe të drejtën për të ndërhyrë, në rast cenimi të pavarësisë së Shqipërisë. Nga ana e saj qeveria britanike prirej për ta bërë publike çështjen shqiptare, pasi kështu iu shmangej përgjegjësive direkte për arritjen e një marrëveshjeje dypalëshe, që mund të ishte problematike në të ardhmen.

Më 28 shtator 1921, në takimin e Konferencës së Ambasadorëve, ambasadori italian dorëzoi draftin e një formule, mbi të cilën kishin rënë dakord qeveria italiane dhe qeveria britanike për ruajtjen e interesave të veçanta italiane në Shqipëri. Me këtë formulë ra menjëherë dakord ambasadori francez dhe zyrtarisht u pranua. Në këtë formulë thuhej: “Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Japonia e njohin që pavarësia dhe integriteti dhe paprekshmëria e kufijve të saj janë çështje të rëndësishme kombëtare. Dhunimi i këtyre kufijve ose i pavarësisë së Shqipërisë mund të

⁴³ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme Britanike nr. 1510/1, Shqipëria, Politika e Përgjithshme, memorandum i lordit Curzon për ambasadorin italian, 26 gusht 1921, f. 168-169. (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

përbëjë kërcënim për sigurinë strategjike të Italisë”.⁴⁴ Në fund të tetorit në FO vinin lajme shqetësuese për grumbullimin e komitëve grekë të armatosur me qëllim kryerjen e sulmeve në Shqipërinë e Jugut. Nga ana e saj FO vazhdonte të dërgonte mesazhe në Athinë se qeveria greke ishte përgjegjëse për çdo zhvillim në Shqipërinë e jugut. Në anën tjetër, serbët kishin pushtuar Lurën dhe Oroshin, duke vazhduar në jug.

Më 9 nëntor 1921 Konferenca e Ambasadorëve mori dy vendime përfundimtare për sa i përket çështjes shqiptare. Së pari, mbi “ratifikimet” në kufirin e veriut dhe njohjen e qeverisë shqiptare. U ratifikuan kufijtë shqiptarë në verilindje të Shkodrës, në perëndim dhe në jug të Prizrenit, në perëndim të Dibrës dhe në rajonin e Linit në liqenin e Ohrit. Ky vendim linte jashtë shtetit shqiptar një pjesë të krahinës së Gollobordës me një popullsi prej 40 mijë vetash. I vetmi element pozitiv në këtë vendim ishte njohja e qeverisë shqiptare. Vendimi i dytë kishte të bënte me njohjen e interesave “strategjike” të posaçme të Italisë në Shqipëri. Gjithashtu, aty shënohej se çdo cenim i kufijve dhe i pavarësisë së Shqipërisë mund të përbente një rrezik edhe për sigurinë strategjike të Italisë. Për këtë Fuqitë pranonin që, në rast të ndonjë sulmi kundër integritetit të Shqipërisë, ajo mund t’i drejtohej për ndihmë Këshillit të Lidhjes së Kombeve në bazë të Statutit.⁴⁵ Edhe pse ky vendim kishte një anë pozitive, se njihej *de juro* dhe *de facto* qeveria shqiptare dhe garantohej sovraniteti i Shqipërisë, nga ana tjetër i njihte të drejta strategjike Italisë në Adriatik në rast cenimi interesash strategjike, çka mund t’i jepte të drejtë për një ndërhyrje më vonë. Ajo që bie në sy në këtë vendim është se Britania e Madhe ka një qëndrim më aktiv në çështjen shqiptare, për faktin se ishin të përfshira interesat italiane në rajon dhe Italia ishte shfaqur si një fuqi e re në rendin e ri ndërkombëtar. Për më tepër që Britanisë i interesonte përkrahja italiane për çështje të tjera në interesin e saj.

Gjatë periudhës së viteve 1922-1923 Britania e Madhe ndjek një politikë pasive ndaj Shqipërisë. Më 14 janar 1922 Eyres u emërua ambasadori i parë britanik në Shqipëri. Ndërsa më 28 mars Mehmet Konica u ngarkua t’i paraqiste letrat kredenciale si ambasadori i parë shqiptar në Britaninë e Madhe. Gjatë kësaj periudhe qeveria britanike interesohet ekonomikisht për Shqipërinë. Megjithëse interesat ekonomike të Britanisë nuk ishin aq të rëndësishme në Shqipëri sa mund të ndikonin për ta ndryshuar kursin e politikës së saj gjatë kësaj periudhe dhe pavarësisht se vendi ndodhej në një situatë të vështirë dhe nevojë emergjente për ndihmë ekonomike, qeveria britanike mbajti një qëndrim indiferent ndaj kërkesave të vazhdueshme për ndihmë ekonomike. Mund të themi se ndryshimi i qëndrimit të qeverisë britanike ndaj çështjes shqiptare ishte i kushtëzuar prej interesave italiane në

⁴⁴ AQSh, F. Ministria e Punëve të Jashtme Britanike, nr. 1510/1. (Dokumente të papërpunuara të dhuruara nga Bejtullah Destani).

⁴⁵ Puto, *Shqipëria...*, f. 298-299.

Ballkan, qëndrimin amerikan në Konferencë si dhe vetë interesave britanike në rajon dhe më gjerë. Edhe pse në mjaft raste diplomacia angleze shfaqet mjaft aktive në çështjen shqiptare, mund të themi se ky aktivizim vinte si rezultat i shumë faktorëve të tjerë ndërkombëtarë. Pas caktimit të Eyres si ambasadori i parë britanik në Shqipëri, qarqet shqiptare besuan te një kahe pro-shqiptare e britanikëve. Pavarësisht prej pasivitetit dhe mosinteresimit për çështjen shqiptare, Britania e Madhe e pranoi ekzistencën faktike të një shteti shqiptar, me gjithë trysinë e fuqive të interesuara për ta copëtuar atë.